

BULETIN I LAJMEVE TË SIGURISË KIBERNETIKE



Qershor 2023

Përmbajtja:

- Shqipëria, e para në stërvitjen rajonale të sigurisë kibernetike të organizuar në formatin e një gare miqësore!
- Siguria kibernetike në sektorin bankar

Siguria kibernetike në sektorin bankar

"Numrat e sigurimeve shoqërore, llogarive bankare dhe kartave të kreditit nuk janë vetëm të dhëna. Në duar të gabuara ata mund të fshijnë kursimet e jetës së dikujt, të shkatërrojnë kredinë e tyre dhe të shkaktojnë shkatërrim financiar."

Melissa Bean



Shqipëria, e para në stërvitjen rajonale të sigurisë kibernetike të organizuar në formatin e një gare miqësore!

Stërvitja kibernetike 4 ditore, e organizuar nga Akademia e Qeverisjes Elektronike të Estonisë (eGovernance Academy), CybExer Technologies, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) dhe autoritetet e tjera kompetente të sigurisë, me mbështetjen e Bashkimit Evropian, u mbajt në Tiranë ku morën pjesë ekspertë të sigurisë kibernetike nga Shqipëria, Mali i Zi, dhe Maqedonia e Veriut. Ekipi shqiptar, i udhëhequr nga përfaqësues të AKSHI dhe AKCESK, me pjesëmarrës dhe nga institucionet e tjera të sigurisë dhe infrastrukturave kritike të informacionit, tregoi aftësi të shkëlqyera në kundërpërgjigjen ndaj një simulimi sulmi kibernetik duke u renditur në vendin e parë.

Aktiviteti u ndoq nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë SH.T.Z. Bajram Begaj së bashku me Presidentin e Republikës së Estonisë, SH.T.Z. Alar Karis dhe Ambasadorin e Bashkimit Evropian SH.S.Znj. Christiane Hohmann.

Drejtori i Përgjithshëm i AKCESK, z. Igli Tafa, në fjalën e tij falënderoi Bashkimin Evropian, Presidentin Estonez, dhe Akademinë e Qeverisjes Elektronike të Estonisë për mbështetjen e vazhdueshme, duke nënvizuar se duke punuar së bashku mund të mbrojmë vendet tona dhe qytetarët tanë nga kërcënimet kibernetike si dhe të krijojmë një të ardhme ku infrastrukturave tona janë të sigurta dhe të qëndrueshme.

Drejtoresha e Përgjithshme e AKSHI, znj. Mirlinda Karçanaj, gjatë këtij aktiviteti falënderoi së pari ambasadorin e BE-së në Tiranë, që bëri të mundur organizimin e këtij aktiviteti, partnerët evropianë e amerikanë që po e mbështesin Shqipërinë, si dhe lavdëroi punën e AKCESK për vendosjen e standardeve dhe rritjen e ndërgjegjësimit në fushën e sigurisë kibernetike, me ndihmën e eGovernance Academy e cila ka dhënë mbështetje në hartimin e kuadrit ligjor si dhe këshillim mbi menaxhimin e sigurisë kibernetike në sektorin privat. Znj. Karcanaj nënvizoi se pas sulmit të sofistikuar ndaj Shqipërisë vitin e kaluar i sponsorizuar nga një shtet jo dashamirës ndaj vendit tonë, këto simulime janë të rëndësishme për rritjen e aftësive të ekspertëve tanë.

Në një kohë kur sfidat e sigurisë kibernetike janë globale, Shqipëria ka shtuar fokusin e saj ndaj rritjes së kapaciteteve teknike për stafet përgjegjëse të sigurisë kibernetike. AKCESK vijon punën intensivisht për forcimin e bashkëpunimit dhe rritjen e nivelit të sigurisë kibernetike duke implementuar praktikatat dhe ekspertizën më të mirë ndërkombëtare.

Me ofrimin gjithnjë e në rritje të shërbimeve bankare, ndërgjegjësimi i këtij sektori për sigurinë kibernetike është një proces kritik.

Në mbarë botën, bankat dhe institucionet financiare janë objekt i shpeshtë i sulmeve kibernetike; siç janë hakerimi i të dhënave të klientëve, vjedhja e identitetit, mashtrimi financiar dhe shfrytëzimi idobësive në infrastrukturën e tyre të informacionit.

Pikërisht, sektori bankar ka qenë këtë javë në vëmendjen e shtuar të AKCESK, për të intesifikuar bashkëpunimin në terma të ndërgjegjësimit dhe rritjes së vigjilencës, në funksion të mbrojtjes kibernetike të infrastrukturave të informacionit.

Prioritizimi i rritjes së kapaciteteve dhe shkëmbimi i informacionit në kohë reale kanë qenë pjesë e diskutimeve dhe takimeve të përditshme, që AKCESK ka zhvilluar gjatë kësaj jave, me këtë sektor.

"Ne jemi aty, sëbashku me ju, për t'ju përgjigjur 24/7 dhe për të adresuar të gjitha çështjet tuaja lidhur me sigurinë kibernetike"- tha Drejtori i Përgjithshëm i autoritetit, në takimet e drejtuara nga vete ai.

"Misioni ynë është i qartë; së bashku të ndërtojmë një ekosistem kibernetik të sigurt për të gjithë, në Shqipëri"



BULETIN I LAJMEVE TË SIGURISË KIBERNETIKE



Përmbajtja:

- AKCESK pjesëmarrje në aktivitetin e OSCE mbi Masat e ndërtimit të Besimit
- AKCESK pjesëmarrje në aktivitetin Cyber Week në Tel Aviv



AKCESK pjesëmarrje në aktivitetin e OSCE mbi Masat e ndërtimit të Besimit

Masat e ndërtimit të besimit (CBM) janë një pjesë integrale e qasjes gjithëpërfshirëse të OSBE-së ndaj sigurisë, të cilat, promovojnë dialogun dhe theksojnë zgjidhjet bashkëpunuese për sfidat e përbashkëta. CBM synojnë uljen e tensioneve, parandalimin e konflikteve dhe promovimin e stabilitetit dhe sigurisë midis shteteve anëtare të OSBE-së. Në këtë kuadër, si pjesë aktive e OSCE, Shqipërisë Ju përcoll ftesa për pjesëmarrje në datat 13- 15 Qershor, ku pjesëmarrës ishin përfaqësues të MEPJ dhe pika teknike e kontaktit për OSCE nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, në takimet si më poshtë:

-Grupi Informal i Punës i krijuar me Vendimin e PC nr. 1039 (IWG) më 13 qershor.

Gjatë ditës së parë, agenda konsistoi në diskutimet paraprake mbi implementimin e CBM 12. Shtetet pjesëmarrëse, mbi baza vullnetare, ndanë informacione dhe mundësuan shkëmbimet ndërshtetërore në formate të ndryshme, duke përfshirë tryezat e rrumbullakëta, në nivel rajonal dhe/ose nën-rajonal. Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, raportoi të gjitha arritjet e kryera sipas secilës CBM. Gjithashtu u pasqyruan edhe të gjitha arritjet e kryera nga Autoriteti në përputhje me CBM 12. -Konsultimet mbi Programin e Veprimit të OSCE-së për të avancuar sjelljen e përgjegjshme të shteteve në përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit në kontekstin e sigurisë ndërkombëtare (PoA) më 14 qershor.

Gjatë ditës së dytë, qëllimi i konsultimit ishte të ofronte një mundësi për shtetet pjesëmarrëse të ndanin pikëpamjet e tyre mbi qëllimin, përmbajtjen dhe modalitetet e programit të OSCE-së me synimin për shqyrtimin e mëtejshëm të këtij propozimi nga Asambleja e Përgjithshme. Konsultimet synonin të pasuronin shqyrtimin e Asamblesë së Përgjithshme të një programi të ardhshëm veprimi të Kombeve të Bashkuara (United Nations) përmes nxitjes së një kuptimi më të thellë të perspektivave rajonale dhe nën-rajonale. Shqipëria dhe kontributin e saj, në përputhje edhe me takimin e mëparshëm të PoA duke pasqyruar deklaratën e përgatitur nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, mbi kontributin e Drejtorisë së Qeverisjes së Sigurisë Kibernetike Kontrollit dhe Zhvillimit Strategjik dhe Drejtorisë së Analizës së Sigurisë Kibernetike si dhe në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme. -Takimi vjetor i pikave kombëtare të kontaktit të emëruar në përputhje me ConfidenceBuilding Measure OSBE-së (CBM) Nr. 8, më 15 Qershor 2023 ku pasqyruan nga vendi jonë synimet për të ardhmen lidhur me aktivitetet dhe bashkëpunimet në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

Sekretariati i OSCE, si një ndër organizatat aktive dhe të përfshira në çështjet e sigurisë kibernetike, theksoi gjithashtu rëndësinë e pjesëmarrjes së Shqipërisë në OEWS (Open-Ended Working Group on Security) dhe United Nations me qëllim adresimin e duhur të gjitha arritjeve dhe progresit të Shqipërisë në çështjet e sigurisë kibernetike, e cila është prioritet në agjendat e të gjitha vendeve të UN, në këto organizma të rëndësishme ndërkombëtar.



AKCESK pjesëmarrje në aktivitetin Cyber Week në Tel Aviv

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me Izraelin, AKCESK morri pjesë aktivisht në aktivitetin "Cyber week", i cili është një ngjarje e madhe vjetore ndërkombëtare e sigurisë kibernetike, e organizuar çdo vit në Universitetin e Tel Avivit.

Gjatë tetë viteve të fundit, Java Kibernetike është vlerësuar ndërkombëtarisht si një nga ngjarjet kryesore të sigurisë kibernetike në botë.

Në një nga panelet e këtij aktiviteti u prezantua Platforma CrystalBall, një platformë që përfshin vende dhe partneritete e cila mundëson analizën dhe ndarjen e informacionit në një mënyrë interaktive, të shpejtë, të sigurt dhe të lehtë midis vendeve për çështjet e mbrojtjes kibernetike. Ajo çfarë u evidentua si në aspektin e teknologjise dhe të ndërveprimit në fushën e sigurisë kibernetike ishte se sfidat e përbashkëta të sigurisë kibernetike, tejkalohen duke punuar së bashku, duke ndarë njohuritë, eksperiencat dhe teknologjitë për mbrojtje më të mirë dhe më të shpejtë.

Gjatë kësaj jave, Zëvendës drejtori i përgjithshëm i AKCESK, zhvilloi një sërë takimesh me përfaqësues të institucioneve homologe nga vendet e tjera pjesëmarrëse, si dhe me industrinë, në terma të rritjes së bashkëpunimit mes vendeve dhe implementimit të zgjidhjeve teknologjike të reja .